

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 108, datë 25.3.2019

PËR KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR ANALIZIMIN, SHQYRTIMIN DHE PËRGATITJEN E REKOMANDIMEVE PËR RREGULLIMIN E KULTIVIMIT, GRUMBULLIMIT, SHITJES DHE POLITIKAVE FISKALE PËR DUHANIN DHE PRODUKTET E TIJ NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të germës “a”, të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, si dhe në zbatim të legjislacionit specifik të fushës në bazë të të cilit ushtrojnë funksionet institucionet pjesë përbërëse e këtij urdhri, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

URDHËROJNË:

1. Krijimin e një grupi të përbashkët pune, me qëllim studimin dhe propozimin e masave për sigurimin e mbështetjes me rregulla të qarta dhe të zbatueshme të industrisë vendase të prodhimit dhe tregtimit të duhanit, me përbërjen si më poshtë:

- drejtor i Politikave Fiskale në MFE (bashkëkryetar);
- drejtor i Agjencisë së Duhanit në MBZHR (bashkëkryetar);
- zv. drejtor i Përgjithshëm i Doganave (anëtar);
- zv. drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve (anëtar);
- drejtor i AKU-së (anëtar);
- përfaqësues nga MBZHR-ja (anëtar);
- përfaqësues nga Shoqata e Fermerëve (anëtar);
- përfaqësues nga industria e duhanit (anëtar);
- përfaqësues nga importuesit e duhan cigareve (anëtar);
- konsulent fiskal i fushës (anëtar).

2. Grupi i përbashkët i punës duhet të:

- analizojë situatën aktuale të kultivimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të duhanit;
- shqyrtojë ligjet dhe aktet nënligjore që janë në fuqi;
- shqyrtojë praktikën më të mira rajonale;
- përgatisë rekomandimet përkatëse afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për përmirësimin e situatës;
- përgatisë paketën me draft dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë të gjitha fazat e kultivimit, përpunimit dhe tregtimit të duhanit, cigareve dhe produkteve alternative.

3. Për nevojat e punës dhe funksionimit të grupit, bashkëkryetarët mund të angazhojnë dhe konsultojnë punonjës të tjerë të institucioneve publike, organizatave, bizneseve dhe përfaqësues të industrisë, fermerë dhe grumbullues.

4. Grupi i punës mbledhet me kërkesën e të paktën njërit prej bashkëkryetarëve. Grupi i punës do të përgatisë raporte pjesore sipas nevojave më urgjente, si edhe raportin përfundimtar me konkluzionet dhe rekomandimet jo më vonë se data 30 qershor 2019.

Ky urdhër hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj**

**MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledi Çuçi**

